5.1.9	Promovimi, bashkëpunimi dhe avancimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.	2024 2025 2026 2027	500.00€	500.00€	500.00€	500.00€	500.00€	KOMUNA E LIPJANIT	DEZH DB DSHPS DKA	Numri i fushatave vetëdijesuese	Raportet mbi aktivitetet e mbajtura		
5.1.10	Monitorimi i implementimit të Planit Komunal të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara.	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT Donatorët si Unicef, USAID OSCE	KOMUNA E LIPJANIT Donatorët si Unicef, USAID OSCE	Numri i raportimeve	Planet Zhvillimore Komonale të aprovuara		
5.1.11	Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe informimi rreth shërbimeve komunale, shëndetësore, arsimore etj. përmes gjuhës së shenjave. Vendosija e ekraneve për informim me gjuhën e shenjave në hapësirat e përbashkëta në të gjitha institucionet publike.	2024 2025 2026 2027	500.00€	500.00€	500.00€	500.00€	500.00€	KOMUNA E LIPJANIT	DB	DB	LIGJI Nr. 04/L-090 PËR Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural		

5.1.12	<p>Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në të parë dhe informimi rreth shërbimeve komunale, shëndetësore, arsimore etj përmes alfabetit braille.</p> <p>Sigurimi i qëndrueshmërisë së funksionalizimit të printerit braille, printimi i materialeve informuese dhe shpërndarja te personat në nevojë. Me tutje, ofrimi i shërbimeve në alfabetin braille për këtë kategori të personave.</p>	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT DSHPS DKA Unicef, USAID OSCE Donatorët	DSHPS DKA Unicef, USAID OSCE Donatorët	Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi Udhëzimi Administrativ për Shëndetësi për KPSH 08/2017 Ligji nr. 08/1-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare
5.1.13	<p>Shërimi i datave ndërkombëtare për promovimin e të drejtave të PAK, pacientëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve ne nevoja te veçanta.</p>	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT DSHPS DKA Unicef, USAID OSCE Donatorët	DSHPS DKA Unicef, USAID OSCE Donatorët	Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi Udhëzimi Administrativ për Shëndetësi për KPSH 08/2017 Ligji nr. 08/1-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare
5.1.14	<p>Fushatë vetëdijesuese rreth rëndësisë së qasjes së plotë të PAK në shërbime, institucione dhe infrastrukture publike.</p>	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT DSHPS DKA DI DSHP	KOMUNA E LIPJANIT DSHPS DKA DI DSHP	Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi Udhëzimi Administrativ

										DSHP DPMU Donatoret	DPMU Donatoret		për Shëndetësi për KPSh 08/2017 Ligji nr. 08/1- 255 për Shërbime Socialë dhe Familjare
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik V.1:</i>					2,500.0 0	2,600.0 0	2,900. 00	3,100. 00				
<b>5.2</b>	<b>Objektivi specifik 2: Sigurimi i qasjes në institucionet publike dhe private për PAK në Komunën e Lipjanit</b>												
<b>1</b>	Treguesi: Përqindja e institucioneve publike komunale që ofrojnë qasje për PAK. Qasje në institucione publike dhe krijimi i kushteve të punës për PAK brenda tyre. Qasje e plotë në institucione shëndetësore. Qasje e plotë në institucione arsimore. Qasje e plotë në infrastrukture publike (rrugë, trotuare, parqe, etj.), si dhe në objektet private shumë banesor.					50%			75%	80%	80%		
<b>Nr.</b>	<b>Veprimi</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Buxheti</b>				<b>Burimi i financimit</b>	<b>Institucioni udhëheqës dhe mbështetës</b>	<b>Produkti (Output)</b>	<b>Referenca në dokumente</b>			
5.2.1	Sigurimi i kushteve teknike për qasjen e personave me aftësi të kufizuar në objektet ndërtimore private me karakter shumë banesor.	2024 2025 2026 2027	2024	2025	2026	2027	KOMUNA E LIPJANIT	DPMU DI DSH	Numri objekteve që sigurojnë qasje	PZHK Harta Zonale			

5.2.2	Sigurimi i qasjes në të gjitha institucionet publike lokale për PAK duke siguruar pjerrinat, lëshesat dhe ashensorët sipas standardeve për PAK.	2024 2025 2026 2027	1,200.0 0	3,000.0 0	4,000.0 0	5,000.0 0	KOMUNA E LIPJANIT DPMU DI DSH DSHIPS DKA QPS SHBK	DPMU DI DSH DSHIPS DKA QPS SHBK	Numri i përgjithshëm i objekteve të cilat sigurojnë qasje të plotë.	PZHK Harta Zonale
5.2.3	Sigurimi i qasjes në të gjitha institucionet private dhe objektet shume banesore për PAK duke siguruar pjerrinat, lëshesat dhe ashensorët sipas standardeve për PAK.	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT DPMU DI DSH DSHIPS DKA, QPS	DPMU DI DSH DSHIPS DKA QPS SHBK	Numri i përgjithshëm i objekteve të cilat sigurojnë qasje të plotë.	PZHK Harta Zonale
5.2.4	Sigurimi i qasjes në të gjitha institucionet shëndetësore në Komunën e Lipjanit sipas standardeve për PAK.	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT	DPMU DI DSHP DSHIPS QPS SHBK	Lista me numrin e përgjithshëm të objekteve shëndetësore dhe numri i atyre të cilat sigurojnë qasje të plotë.	PZHK Harta Zonale
5.2.5	Sigurimi i qasjes në QPS dhe Qendrën Rezidenciale (pjerrinat, lëshesat, ashensori nëse objekti ka kate mbi katin përdhese) sipas standardeve për PAK.	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT	DPMU DI DSHP DSHIPS QPS SHBK	Numri i përgjithshëm i objekteve sociale dhe rezidenciale dhe numri i atyre të cilat sigurojnë qasje të plotë.	PZHK Harta Zonale
5.2.6	Sigurimi i qasjes në të gjitha institucionet edukative dhe arsimore në Komunën e Lipjanit sipas	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT	DPMU DI DSHP DKA	Numri i përgjithshëm i objekteve edukative dhe arsimore dhe	PZHK Harta Zonale

standardeve për PAK.										numri i atyre të cilat sigurojnë qasje të plotë.	
5.2.7	Sigurimi i qasjes në tualete për PAK në të gjitha institucionet edukative dhe arsimore, shëndetësore dhe institucioneve tjera publike në Komunën e Lipjanit sipas standardeve për PAK.	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT	DPMU DI DKA DSHIPS	Numri i përgjithshëm i objekteve publike dhe numri i atyre të cilat sigurojnë qasje të plotë.	Institucionet që ofrojnë qasje të plotë	
5.2.8	Sigurimi i kushteve të punës për PAK brenda institucioneve publike në Komunën e Lipjanit sipas standardeve për PAK.	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	KOMUNA E LIPJANIT	DPMU DSHIPS DKA DA	Vendet e punës me standarde.	Institucionet që ofrojnë qasje të plotë	
5.2.9	Sigurimi dhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal i parkingjeve për PAK brenda institucioneve publike në Komunën e Lipjanit dhe në parkingjet publike, si dhe mirëmbajtja e tyre.	2024 2025 2026 2027	1,500.0 0	1,500.0 0	1,500.0 0	1,500.0 0	KOMUNA E LIPJANIT	DPMU DI DSHP DSHIPS DKA, DA	Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike dhe numri i atyre të caktuar për PAK.	Institucionet që ofrojnë qasje të plotë	
5.2.10	Përshtatja e infrastrukturës sipas nevojave të PAK në stacionet e transportit publik.	2024 2025 2026 2027	3,000.0 0	3,000.0 0	3,000.0 0	3,000.0 0	KOMUNA E LIPJANIT	DPMU DL, DSHP DBF DSHIPS DKA	Stacionet publike me qasje të plotë për PAK.	Planifikimet Buxhetore vjetore	
5.2.11	Pajisja e mjeteve të transportit me pjerrina, dhe mjete tjera të nevojshme për kategoritë e ndryshme të PAK me qëllim të qasjes së plotë.	2024 2025 2026 2027	0	1,500.0 0	1,500.0 0	1,500.0 0	KOMUNA E LIPJANIT D	DPMU DI DSHP DF	Mjetet komunale të pajisura me mjetet e nevojshme për PAK.	Planifikimet Buxhetore vjetore	
5.2.12	Përfshirja e PAK në aktivitete rinore, sportive, kulturore dhe artistike	2024 2025 2026	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto	Nuk ka kosto	Nuk ka kosto	KOMUNA E LIPJANIT	DKRS KA DSHIPS	Numri i aktiviteteve si; gara me karroce, shah, kampe verore,	Numri i aktiviteteve, raportuara	

											aktivitete kulturo-artistike, etj.	
5.2.13	Mbështetja e aktivitete rinore, sportive, kulturore dhe artistike të PAK.	2024 2025 2026 2027	1,000.0 0	2,000.0 0	3,000.0 0	3,000.0 0	Donatorët KOMUNA E LIPJANIT	DKRS DKA DSHPS Donatorët	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Numri i aktiviteteve të raportuara
5.2.14	Mbështetja financiare e lojërave sportive të PAK, si: futsal, volejbol, pingpong, shahu, etj. si dhe financimi për rekuizita të nevojshme për sporte.	2024 2025 2026 2027	1,500.0 0	2,500.0 0	3,000.0 0	5,000.0 0	Donatorët Komuna e Lipjanit	DRKS	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Raportet financiare	Raportet financiare
5.2.15	Organizimi i aktiviteteve nga Olimpiada Speciale e Kosove për PAK.	2024 2025 2026 2027	1,000.0 0	1,500.0 0	2,500.0 0	3,500.0 0	Donatorët Komuna e Lipjanit	DRKS	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Numri i aktiviteteve të raportuara	Numri i aktiviteteve të raportuara
5.2.16	Mbështetja financiare për mbajtje të ekskursioneve të PAK.	2024 2025 2026 2027	5,000.0 0	6,000.0 0	7,000.0 0	15,000.0 00	DRKS DSHPS Donatorët	DRKS	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Numri i aktiviteteve të mbështetura	Raportet financiare	Raportet financiare
5.2.17	Sigurimi i hapësirave, për shërbime të PAK	2024 2025 2026 2027	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Nuk ka kosto shtesë	Donatorët Komuna e Lipjanit	Zyra e Kryetarit DPMU DSHPS DKA DRKS	Vendimi për sigurimin e zyrave	Vendimi për sigurimin e zyrave	Vendimi për ndarjen e hapësirave	Vendimi për ndarjen e hapësirave
5.2.18	Rregullimi i sipërfaqeve taktile dhe vendosja e pllakave taktile në infrastrukturën e jashtme dhe ambientet e brendshme të institucioneve publike si QKMF, QMF, AMF, Shkolla, Objekti i Komunës, Biblioteke, Shtëpi të Kulturës, QPS, etj.	2024 2025 2026 2027	Shpenzimet Ilogarit brenda projektve infrastrukturo	Shpenzimet Ilogarit brenda projekteve	Shpenzimet Ilogarit brenda projektve	Shpenzimet Ilogarit brenda projektve	Donatorët Komuna e Lipjanit	DSHPS DKA DI DSHP DRKS QKMF QPS	Numri i projekteve me pllakave taktile.	Numri i projekteve me pllakave taktile.	Projektet e hartuara	Projektet e hartuara

		re	infrastrukturore	teve infrastrukturore	teve infrastrukturore					
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektin Specifik V.2:</i>	14,200.00	21,000.00	25,500.00	37,500.00					
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektin Strategjik V:</i>	16,700.00	23,600.00	28,400.00	40,600.00					
	<i>Totali i Buxhetit për Planin e Veprimtë për PAK (1+2+3+4+5):</i>	65,550.00	105,000.00	118,100.00	136,900.00					



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMUNA E LIPJANIT

**STRATEGJIA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR  
NË KOMUNËN E LIPJANIT 2024-2027**

Lipjan, 2024



## Përmbajtja

Fjala e Kryetarit .....	3
Lista e shkurtesave.....	4
Falënderim.....	5
Përmbledhje ekzekutive.....	6
1. Hyrje.....	6
2. Metodologjia.....	7
3. Sfondi.....	7
SWOT ANALIZA.....	10
4. ANALIZA E AKTERËVE.....	10
5. Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike.....	11
6. MONITORIMI DHË RAPORTIMI.....	15
7. REFERUARENCA.....	15
8. Aneks 1, Plani i Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara.....	15

Fjala e Kryetarit,

Komuna e Lipjanit është e përkushtuar për të siguruar një përfshirje të plotë të personave me aftësi të kufizuar në jetën sociale, ekonomike dhe institucionale pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, religjionit apo prejardhjes.

Strategjia për personat me aftësi të kufizuar është një angazhim serioz i cili synon të krijoj një ambient i cili garanton mundësi të barabarta dhe respektim të plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Bashkëpunimi dhe përkushtimi ynë për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe për të gjithë njësoj është thelbi i kësaj strategjie dhe i filozofisë sonë qeverisëse.

I juaji,

Imri AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit

## Lista e shkurtesave

**ZKA** Zyrtari Kryesor Administrativ

**KK** Kuvendi Komunal

**PAK** Personat me Aftësi të Kufizuar

**DSHPS** Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

**DKA** - Drejtorati Komunal i Arsimit

**DPUMM** Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

**DSHP** Drejtoria e Shërbimeve Publike

**DI** Drejtoria e Infrastrukturës

**DA** Drejtoria e Administratës

**QPS** Qendra për Punë Sociale

**MAPL** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**OShC** Organizatat e Shoqërisë Civile

**HANDIKOS** Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës

**OPAK** Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuar

**OJQ** Organizata Joqeveritare

**QKMF** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

**QMF** Qendra e Mjekësisë Familjare

**AMF** Ambulanta e Mjekësisë Familjare

**ASK** Agjencioni i Statistikave të Kosovës

**MSH** Ministria e Shëndetësisë

**MASHT** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

**MMPHI** Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

**MBPZHR** Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**MAPL** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**MD** Ministria e Drejtësisë

**MFPT** Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

**ZQM** Zyra për Qeverisje të Mirë

**SNPAK** Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023

**SPSKL** Strategjia mbi Përfshirjen Sociale për Komunën e Lipjanit 2022-2024

**PPEDF** Plani i Punës për të Drejtat e Fëmijëve i Komunës së Lipjanit 2024-2026

**VVPAK** Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023

**KAB** Korniza Afatmesme Buxhetore

**NJDNJMD** Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtje nga Diskriminimi

**KDPAK** Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

**OBSH** Organizata Botërore e Shëndetësisë

**PPEDF** Plani i Punës për të Drejtat e Fëmijëve i Komunës së Lipjanit 2024-2026

**PVT** Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Lipjanit 2023-2027

**PKI** Plani Komunal për Integritet i Komunës së Lipjanit 2023-2026

**PVRL** Plani i Veprimit Rinor Lokal i Komunës së Lipjanit 2022-2024

**PB** Programi trevjeçar për banim i Komunës së Lipjanit 2022-2025

## FALËNDERIM

Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar për Komunën e Lipjanit 2024-2027 është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën Down Syndrome Kosova dhe është përkrahur nga UNICEF, në partneritet me USAID në kuadër të projektit “Fuqizimi i cilësisë së shërbimeve të integruara, efektive dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe adoleshentët me aftësi të kufizuara intelektuale” dhe është mbështetur nga OSBE Misioni në Kosovë.

Grupi punues i themeluar nga Kryetari i Komunës, i përberë nga përfaqësuesit nga zyra e Kryetarit dhe nga drejtoritë relevante si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, kanë dhënë një kontribut të veçantë duke analizuar gjendjen, identifikuar resurset dhe kompetencat, nevojat dhe objektivat strategjike të realizueshme dhe duke i zbërthyer në aktivitete konkrete të buxhetuara si dhe duke caktuar institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore të implementimit.

Komuna e Lipjanit i falënderon për përkrahje dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm UNICEF, OSBE Misionin në Kosovë, USAID, Shoqatën Down Syndrome Kosova, anëtarët e grupit punues, OSHC-të dhe qytetarët të cilët kanë marrë pjesë aktive në tryezat dhe diskutimet publike.

Hartimin i këtij dokumenti është shumë i rëndësishëm ngase synon avancimin e mirëqenies sociale, gjithë përfshirjen në arsim, informimin, sigurimin e qasjes në shërbime dhe infrastrukturë publike si dhe avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar të cilët jetojnë ose marrin shërbime në Komunën e Lipjanit.

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Komunën e Lipjanit 2024-2027 përfshinë një plan të gjerë të veprimeve për të siguruar gjithë përfshirje të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Në përmbledhje, ky dokument do të përfshijë hulumtimin dhe identifikimin e nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuar, zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve komunale dhe infrastrukturës për të adresuar këto nevoja, si dhe promovimin e përfshirjes dhe të drejtave të tyre në shoqëri.

Më tutje, Strategjia do të përfshijë mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të sajë për të siguruar që qëllimi kryesor, objektivat dhe aktivitetet e parapara të përmbushen në mënyrë efektive.

Qëllimi i Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Komunën e Lipjanit 2024-2027 është të siguroj një mjedis të barabartë dhe gjithëpërfshirës për Personat me Aftësi të Kufizuar. Kjo përfshinë garantimin e të drejtave të barabarta, përmirësimin e qasjes në shërbime dhe mundësi të barabarta në të gjitha sferat e jetës, duke përfshirë, por duke mos u limituar, shëndetësinë, arsimin, punësimin, dhe të drejtat tjera themelore njerëzore.

Në fund, Qëllimi themelor është të promovohet, avancohet dhe të mundësohet e të mbrohet përfshirja dhe integrimi i plotë i personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore dhe ekonomike.

## 2. HYRJE

Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027 është dokument strategjik me prioritet i Komunës së Lipjanit i cili është hartuar dhe drejtuar nga nevojat e personave me aftësi të kufizuar.

Ky dokument synon të ndërtoj resurset dhe kompetencat, mekanizmat dhe infrastrukturën për të krijuar mundësi për personat me aftësi të kufizuar të përfitojnë maksimumin nga aftësitë e tyre në mënyrë të barabartë.

Kjo strategji ndërton një mënyrë tjetër, më të avancuar dhe gjithëpërfshirëse për ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për të gjithë personat pa dallim dhe siguron përmirësimin e qasjes në shërbime administrative dhe publike, infrastrukture, shërbime shëndetësore, arsim dhe qasje adekuate në shërbime sociale dhe familjare.

Më tutje, përmes ndërtimit të dialogut dhe komunikimit, rritjes së qasjes në informacion, si dhe mbledhjes dhe menaxhimit të koordinuar të të dhënave kjo strategji synon të avancoj më tutje pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në vendimmarrje dhe pjesëmarrje aktive në shoqëri.

Për zhvillimin dhe hartimin e këtij dokumenti janë organizuar punëtori, konsultime dhe dëgjime publike, janë marrë kontribute nga ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve komunale në fushën e shërbimeve sociale, shëndetësisë, arsimit, punësimit, infrastrukturës dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile.

Hartimi i kësaj strategjie dhe Planit të Veprimit është bërë në bashkëpunim me Shoqatën Down Syndrome Kosova dhe UNICEF në partneritet me USAID në kuadër të projektit “Fuqizimi i cilësisë së shërbimeve të integruara, efektive dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe adoleshentët me aftësi të kufizuara intelektuale” dhe është mbështetur nga OSCE Misioni në Kosovë.

Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027 ndërlidhet me një sërë dokumentesh strategjike të Komunës së Lipjanit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës si: Strategjia mbi Përfshirjen Sociale dhe Plani i Veprimit 2022 – 2024, Plani Zhvillimor Komunal (2012-2023), Kornizën Afatmesme Buxhetore (2024-2026), Planin Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2023-2026, Planifikimin e Buxhetit të Komunës së Lipjanit 2024-2026), Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 (SVL), Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2016 dhe është e hartuar në harmoni me Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023, si dhe në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

### 3. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në hartim të kësaj strategjie përfshinë një metodologji të kombinuar dhe një proces të mbledhjes së të dhënave përmes një instrumenti të gjysmë-strukturuar, analizë të situatës aktuale, punëtorive me grupet punuese brenda dhe jashtë vendit dhe konsultim të vazhdueshëm me akterët e ndryshëm relevant.

Pjesëmarrës në këto grupe punuese kanë qenë përfaqësues të institucioneve lokale të tilla si: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria e Arsimit, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë tjera relevante, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Qendra për Punë Sociale, Zyra për Barazi Gjinore, Shtëpia me Bazë në Komunitet dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Grupi punues ka adresuar nevojat dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë diskutuar dhe trajtuar në grup si dhe me personat me aftësi të kufizuar, në bazë të cilave pastaj janë përcaktuar objektivat e përgjithshme dhe objektivat specifike dhe të cilat më tutje janë zbërthyer në aktivitetet specifike të buxhetuara brenda Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027.

Strategjia është hartuar sipas udhëzimit administrativ nr.07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.

### 4. SFONDI

Rreth 1.3 miliardë njerëz përjetojnë aftësi të kufizuara të konsiderueshme. Kjo përfaqëson 16% të popullsisë së botës, ose 1 në 6 prej nesh<sup>1</sup>.

Është punuar shumë nga Komuna e Lipjanit në drejtim të përmirësimit të gjendjes dhe sigurimit të një përfshirje të plotë të personave me aftësi të kufizuar në jetën sociale, ekonomike dhe institucionale. Megjithatë, shumë ka mbetur për tu bërë për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës i cili garanton qasje dhe mundësi të barabarta si dhe respektim të plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Komuna e Lipjanit është angazhuar shumë për të siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuara në infrastrukturë, në shërbime administrative komunale, shërbime shëndetësore, arsimore, informim dhe shërbimet tjera.

Është bërë identifikimi i barrierave infrastrukturore për qasje fizike në shërbime. Të gjitha rrugët dhe trotualet janë me lëshesa për qasje, si në qytet ashtu edhe në fshatra. Semaforët në rrugën kryesore në Qytetin e Lipjanit janë me zë. Të gjitha institucionet publike kanë siguruar qasje përmes pjerrinave. Në objektet e Komunës së Lipjanit, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në Qendrën për Punë Sociale janë siguruar dhe futur në funksion ashensorët për të siguruar

---

<sup>1</sup> <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/disability-and-health>

qasjen e personave me aftësi të kufizuara në katet me të larta se kati përdhësë. Shumica e ndërtesave private me karakter të banimit banesor ofrojnë pjerrinat dhe ashensorët për qasje të lehtë.

Që nga viti 2022 Komuna e Lipjanit është e gatshme të ofroj dokumentet për personat e verbër në alfabetin Braille. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka siguruar Printerin Braille për ofrim të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar në të pamur. Ky Printer është instaluar në sportelin e Komunës dhe ofron të gjitha dokumentet për këtë kategori.

Në ambientet e Objektivit të Komunës së Lipjanit dhe në ato të QKMF-së janë të vendosur ekrane për informim me zë dhe në gjuhën e shenjave, si dhe edukim dhe promovim të shërbimeve administrative dhe shërbimeve shëndetësore.

Është bërë punësimi i asistentëve, për fëmijë me aftësi të kufizuara të përfshirë në shkolla të rregullta në mënyrë që të mbështeten nevojat e tyre arsimore nga Drejtoria e Arsimit.

Janë krijuar dhomat burimore të pajisura me materiale didaktike dhe me teknologji asistive në të gjitha shkollat, si dhe krijimi i hapësirave të përshtatshme në kuadër të shkollave nga Drejtoria e Arsimit.

Është bërë fuqizimi i ekipeve vlerësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara për proceset arsimore- edukative dhe angazhimi i zyrtarëve/it për fëmijë me nevoja të veçanta nga Drejtoria e Arsimit. Në këtë kuptim, është angazhuar edhe DSHPS përmes Programit Kujdesi për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare.

Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me SOS fshatrat në 2024 për krijimin e programeve për prindër strehues për të gjitha kategoritë duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo marrëveshje ka për qëllim të ofroj shërbime të ndryshme për fuqizimin e familjeve strehuese dhe adaptuese ku fokus është ofrimi i shërbimeve direkte psiko-sociale për fëmijët dhe prindërit strehues, si dhe ngritja e kapaciteteve për prindër me qëllim të përmbushjes së standardeve të kujdesit për fëmijët.

Në krahasim me disa Komuna tjera brenda Kosovës, Komuna e Lipjanit ka bërë një avancim më të shpejtë në sigurimin e qasjes dhe përmbushjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

#### SWOT ANALIZA

Analiza SWOT prezenton ndërlidhjen e të gjithë faktorëve të cilët ndikojnë në gjendjen e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar dhe në realizimin e të drejtave për këtë kategori. Me tutje, kjo analizë prezenton avantazhet dhe disavantazhet e elementeve të brendshme pozitive dhe negative në të cilët mund të ndikohet, ndërsa mundësitë dhe rreziqet e jashtme negative dhe pozitive në të cilat nuk mund të ndikohet por mund të planifikohen dhe harmonizohen.

<b>PERPARESITË</b>	<b>DOBESITË</b>
--------------------	-----------------

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Investimet komunale në sigurimin e qasjes së lehtë në infrastrukturë dhe objekte publike.</li> <li>• Investimet në fushën e shëndetësisë dhe arsimit në ofrimin e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre përmes asistentëve dhe programeve të veçanta.</li> <li>• Bashkëpunimi i shkëlqyeshëm me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në mbështetjen e hartimit të dokumenteve të cilat rregullojnë të drejtat e PAK si dhe mbështetja e konsultimeve dhe dëgjimeve publike rreth nevojave të PAK.</li> <li>• Bashkëpunim të shkëlqyeshëm me HandiKOS.</li> <li>• HandiKOS ka një shtrirje të gjerë në të gjithë Kosovën duke përfshirë edhe Lipjanit. Po ashtu, edhe OMPAK ka zyrën në Lipjan.</li> <li>• Shkollimi dhe trajnimi: në Kosovë ka programe dhe institucione të specializuara për të ofruar trajnime dhe shkollim për persona me aftësi të kufizuara.</li> <li>• Ndërgjegjësimi dhe mbështetja shoqërore. Ka një ndërgjegjësim dhe mbështetje të rritur në shoqëri për të integruar persona me aftësi të kufizuara në jetën sociale dhe ekonomike. Vullneti i lartë i Komunës së Lipjanit për buxhetimin e shërbimeve, angazhim më të lartë në avokim dhe lobim për të drejtat e PAK.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e bazës së të dhënave.</li> <li>• Nevoja për avancim të mëtejshëm të infrastrukturës: Infrastruktura e kufizuar mund të bëjë që personat me aftësi të kufizuara të kenë vështirësi në qasje në ambiente të rëndësishme si shkolla, zyrat dhe objektet publike.</li> <li>• Mungesa e qasjes në transport dhe mjete transportuese publike.</li> <li>• Diskriminimi dhe stereotipet: Diskriminimi dhe stereotipet sociale mund të pengojnë integrimin e tyre në shoqëri dhe në tregun e punës.</li> <li>• Kufizimet buxhetore: Buxheti i kufizuar i qeverisë mund të ndikojë në kualitetin dhe qasjen e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara.</li> <li>• Mungesa e qendrave të rehabilitimit dhe mbështetja e pamjaftueshme për to,</li> <li>• Papunësia e lartë në rritje.</li> </ul>
<b>MUNDËSITË</b>	<b>RREZIQËT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e ndërgjegjësimin dhe edukimit: Mundësitë për të rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin në shoqëri për aftësitë e kufizuara mund të hapin dyert për më shumë punë dhe përfshirje sociale.</li> <li>• Zhvillimi i programeve të punësimit: Zhvillimi i programeve të punësimit të specializuara dhe të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara mund të ndihmojë në integrimin e tyre në tregun e punës.</li> <li>• Ndërmarrja e masave ligjore dhe politikave: Ndërmarrja e masave ligjore dhe politikave të mirëfillta për të mbrojtur dhe përmirësuar të drejtat dhe mundësitë e personave me aftësi të kufizuara mund të ndikojnë në jetën e tyre në mënyrë pozitive.</li> <li>• Investime të mëtejshme në infrastrukturë.</li> <li>• Ngritja e kapaciteteve të PAK.</li> <li>• Zgjerimi dhe modernizimin e objekteve.</li> <li>• Përmirësimi i sektorit të shërbimeve.</li> <li>• Përmirësimi i bashkëpunimit me komunat fqinje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e ndërgjegjësimin të mjaftueshëm: Mungesa e ndërgjegjësimin dhe informacionin për aftësitë e kufizuara mund të çojë në mungesë të përkrahjes dhe mundësive për PAK.</li> <li>• Pabarazitë shoqërore: Pabarazitë shoqërore dhe ekonomike mund të rriten dhe të shkaktojnë vështirësi shtesë për persona me aftësi të kufizuara.</li> <li>• Mungesa e mundësive të punësimit: Mungesa e mundësive të punësimit të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara mund të shkaktojë varfëri dhe izolim social për ta.</li> <li>• Ndarjet buxhetore për kujdesin shëndetësor.</li> <li>• Shpërngulja e kuadrove profesionale jashtë vendit.</li> </ul>



Në bazë të analizës së gjendjes përmes SWOT analizës mund të arrijmë në përfundim se kemi një numër të madh të përparësive për avancimin e mëtutjeshëm të të drejtave dhe përmirësimin e qasjes në shërbime komunale për personat me aftësi të kufizuara ku ndër më të rëndësishmet veçojmë: investimet komunale në sigurimin e qasjes së lehtë në infrastrukturë dhe objekte publike, investimet në fushën e shëndetësisë dhe arsimit në ofrimin e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre përmes asistentëve dhe programeve të veçanta, et.. Megjithatë, ekzistojnë shume vështirësi të cilat mund të vështirësojnë realizimin e objektivave tona për përmirësimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara dhe avancimin e të drejtave të tyre. Sfidë mbetet mbledhja sistematike e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e ndjeshme dhe krijimin i bazës së përgjithshme të dhënave për të gjitha kategoritë e ndjeshme, si dhe harmonizimi i bazës së përgjithshme të të dhënave me ato ekzistuese të institucioneve publike dhe të gjithë akterëve tjerë relevant. Më tutje, sfida është mungesa e qasjes në transport dhe mjete transportuese publike dhe private.

## ANALIZA E AKTERËVE

Komuna e Lipjanit bashkëpunon me një numër të madh të akterëve relevant vendor dhe ndërkombëtar në hartimin e planeve dhe implementimin e tyre për njohjen dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara. Institucionet dhe akterët me të cilët do të bashkëpunoj Komuna e Lipjanit përfshijnë: institucionet e nivelit qendror dhe ato lokal, zyrtarët për të drejta të njeriut, Avokatin e Popullit, shoqërinë civile, personat me aftësi të kufizuara, familjet e tyre dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara si HandiKOS, OMPAK, agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare si Organizata Botërore e Shëndetësisë, USAID, OSCE UNICEF, UNDP, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuara, Save the Children, SDC, AQH, IHC, etj.

## LEGJISLACIONI

Strategjia Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara në komunën e Lipjanit, është hartuar në përputhje dhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013 - 2023 dhe të Planit të Veprimit Për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013 – 2015, si dhe duke i konsultuar të gjitha dokumentet tjera vendore dhe ndërkombëtare të cilat e rregullojnë çështjen e personave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për PAK është gjithë përfshirja, eliminimi i barrierave ekzistuese dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, përmes gëzimit të të drejtave bazë në punësim, arsimim, shërbime shoqërore dhe qasje e plotë dhe inkuadrim në jetën shoqërore në komunën e Lipjanit.

Struktura e SPAK është e organizuar në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë paraqet kontekstin në të cilin është hartuar SPAK si edhe procesin i cili ka shoqëruar formulimin e kësaj strategjie, kuadrin ligjorë, nocione bazë dhe të dhëna të përgjithshme.

Pjesa e dytë është një analizë cilësore në fushën e shërbimit shoqëror, arsimit, punësimit e formimit profesional dhe përshtatshmërisë së ambienteve.

Pjesa e tretë përmban ndërhyrjet strategjike në secilën nga fushat për periudhën kohore 2024-2026 për përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Lipjanit.

## 5. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

### VIZIONI

Shoqëri ku të gjithë individët, pavarësisht nga aftësitë e tyre, janë të integruar plotësisht, gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre dhe për të kontribuar në zhvillimin e Komunës së Lipjanit.

### MISIONI

Mision i kësaj strategjie është të siguroj që personat me aftësi të kufizuara realizojnë të drejtave të barabarta, kanë mirëqenie dhe jetë cilësore, qasje të plotë në infrastrukture fizike dhe shërbime, si dhe pjesëmarrje në vendimmarrje komunale.

### OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Lipjanit 2024-2027 do të paracaktoj politikat lokale, veprimet dhe strategjitë sektoriale të Komunës së Lipjanit dhe institucioneve tjera relevante. Si rrjedhojë ka për qëllim të transmetoj synimet e Komunës së Lipjanit në fushën e të drejtave të njeriut, jo diskriminimit, sigurimit të plotë të qasjes në shërbime, mundësive të barabarta dhe përfshirjes së plotë të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Strategjia është e strukturuar në pesë (5) fusha të cilat përfshijnë të gjitha aspektet kryesore të jetës së Personave me Aftësi të Kufizuara me fokus në fushat si në vijim: Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Punësim, Arsimi, Pjesëmarrja në vendimmarrje dhe Qasja e plote duke përfshirë informimin, komunikimin dhe pjesëmarrjen.

Këto fusha janë të bazuara në çështjet të cilat janë ngritur dhe identifikuar si problematike për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Për përmirësimin e gjendjes aktuale nga fushat prioritare të përzgjedhura në Strategji, janë përcaktuar objektiva strategjike të cilat do të detajohen dhe specifikohen edhe me veprime konkrete, synime, tregues të matshëm, specifik, të arritshëm, real, institucione përgjegjëse për zbatimin e secilit aktivitet, afate kohore dhe linja buxhetore të ndara në kuadër të planeve të veprimit.

**Objektiva Strategjike 1:** Avancimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

**Objektiva Strategjike 2:** Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenie dhe siguri sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

**Objektiva Strategjike 3:** Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara.

**Objektiva Strategjike 4:** Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në vendimmarrje.

**Objektiva Strategjike 5:** Krijimi i qasjes së plotë, informimi me kohë dhe promovimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

#### REALIZIMI I OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

**Objektiva Strategjike 1:** Avancimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

Përmes kësaj objektive strategjike, Komuna e Lipjanit synon të përmirësoj shëndetin publik duke avancuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe duke i përshtatur ato me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Promovimi dhe edukimi shëndetësor zë një vend shumë të rëndësishëm në këtë strategji. Përmes promovimit dhe edukimit shëndetësor Komuna e Lipjanit synon përmirësimin e shëndetit dhe jetës së të gjithë qytetarëve të sajë pa përjashtim.

Në kuadër të kësaj strategjie janë parapare përmirësimi i qasjes fizike në institucionet shëndetësore dhe në shërbime, ofrimi i shërbimeve të duhura shëndetësore duke përfshirë edhe vizitat në shtëpi për pacientet të shoqëruar me vështirësi në lëvizje si dhe vizitat dhe shërbimet e paliativit.

Në kuadër të shërbimit vizitat për nënat dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeçare, synojmë zbulimin e hershëm dhe identifikimin e aftësisë së kufizuar prej kohës prenatale, natale dhe në fazat e mëvonshme. Po ashtu, planifikohet të organizohen kampanja vetëdijësuese për identifikimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ofrimin e shërbimeve të duhura.

**Objektiva Strategjike 2:** Sigurimi i gjithë përfshirjes sociale dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Përmes objektivit të dytë strategjik synojmë të krijojmë një ambient shoqëror me mundësi të barabarta dhe shërbime sociale gjithëpërfshirëse të cilat i përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Me këtë dokument ne angazhohemi që shërbimet sociale të jenë jo vetëm të disponueshme por të qasshme, efektive dhe të qëndrueshme.

Me tutje, përmes këtij objektivi, kemi për qëllim të përmirësojmë qasjen, të bëjmë ngritjen e resurseve dhe kompetencave të shërbyeseve civil dhe publik për realizimin e të drejtave të PAK në njërin dhe të PAK në anën tjetër për të shfrytëzuar të drejtat e tyre dhe për të siguruar mirëqenien e tyre.

**Objektiva Strategjike 3:** Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen e plote në edukim dhe arsim të personave me aftësi të kufizuara dhe mbështetja profesionale.

E drejta në arsim është një detyrim ligjor dhe moral për çdo shoqëri, institucion dhe individ. Andaj, objektivi strategjik numër tre synon të garantoj të drejtën në arsim për PAK marrë parasysh se

arsimi është një e drejtë themelore e njeriut e njohur nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe nga Konventa për të Drejtat e personave me Aftësi të Kufizuara.

Arsimi është një faktor kryq për pavarësimin e PAK i cili u jep mundësi për të qenë pjesë aktive, për të kontribuar dhe për të qenë të barabartë në jetën shoqërore dhe ekonomike.

**Objektiva Strategjike 4:** Krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Përmes përfshirjes së PAK në takime, tryeza, diskutime publike dhe në hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, Komuna e Lipjanit synon të siguroj një mirëqenie të mirë dhe qasje të plote për PAK.

Dokumentet publike të hartuara bashkë me PAK sigurojnë një infrastrukturë të mirë ligjore lokale e cila mbron dhe promovon të drejtat e PAK.

Me tutje, infrastrukturën ligjore, sipas kësaj objektive, do ta shoqëroj edhe themelimi i trupave dhe ekipeve multidisiplinare për sigurimin e implementimit, monitorimit dhe raportimit të infrastrukturës ligjore.

**Objektiva Strategjike 5:** Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një baze të unifikuar të të dhënave për personat me aftësi të kufizuara.

Ofrimi i informacionit mbi njoftimet publike, ofrimi i shërbimeve publike në gjuhën e shenjave për personat me vështirësi në të dëgjuar, si dhe printimi i materialeve për personat me vështirësi në të parë është synim i kësaj objektive strategjike. Kjo do të krijonte mundësi të mira për një qasje të plotë në informim dhe në shërbime publike.

Kjo objektive synon të identifikoj çdo barriere infrastrukturore qasje fizike në rrugë, trotuare, parqe, objekte të institucioneve publike, objekte shume banesore private, transport publik etj. dhe të siguroj ndërtimin e resurseve dhe ndërtimin e mekanizmave për eliminimin e këtyre barrierave me qëllim të sigurimit të qasjes së plote për PAK.

## 6. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Zbatimi i kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit, është obligative. Monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti strategjik e bënë Këshilli Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara në Lipjan, i themeluar nga Kuvendi Komunal dhe Drejtorati për Administratë - Njësi për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Siç është e specifikuar me legjislacionin në fuqi rreth raportimit të implementimit të dokumenteve strategjike, implementimi i këtij dokumenti duhet të raportohet para Asamblesë Komunale.

Më tutje, Komuna e Lipjanit obligohet që në baza gjashtë mujore ti raportoj Zyrës për Qeverisje të Mirë rreth sfidave dhe zbatimit të Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

## 7. REFERENCAT

- Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023,
- Plani Zhvillimor Komunal (2012-2023),
- Planifikimi i Buxhetit të Komunës së Lipjanit 2024-2026,
- Korniza Afatmesme Buxhetore (2024-2026),
- Plani Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2023-2026,
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026,
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2016
- Karta e Kombeve të Bashkuara,
- Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut,
- Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Aneks 1, Plani i veprimit për persona me aftësi të kufizuara 2024-2027, Matrica.